REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 112/20
Datë/Datum. 18.02.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KUVENDI KOMUNAL- GJILAN

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 651-19-7027-1-2-1

Sa i përket tenderit për Digjitalizimi i stacionit të autobusëve në Komunën e Gjilanit

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NAS SYSTEMS SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

RR.ENVER MIFTARI, PN

(Adresa)

GJILAN — *(Vendi)*

60000 — *(Kodi postar)*

0280 330 111 — *(Numri Telefonit)*

- — *(Numri i Faks-it)*

VALON SALIHU

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

VALON@NAS-SYSTEMS.COM

(Adresa elektronike)

18.02.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

Sh.p.k NAS systems 60000 Gjilan - Kosovë

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi për kontratë është shpallur me datë 31.12.2019 ndërsa afati për dorëzimin e tenderit ka qenë me datë 10.01.2020, ora 14:00. Tenderi është anuluar dy herë pas vendimit të OSHP-së dhe kjo është hera e tretë e tenderimit. Kriteri për dhënie të kontratës është Çmimi më i ulët. Me datë 04.02.2020 kemi pranuar B58 Njoftim mbi vendimin e AK dhe Letër standard për tenderuesin e suksesshëm. Pas pranimit të njoftimit, kemi bërë kërkesë për qasje në dokumentacion me datë 06.02.2020.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒

5. **Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

A jeni njofturar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] *Jo* [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] Jo [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.
Me datë 10.02.2020 kemi bërë kërkesë për Rishqyrtim të vendimit të AK ndërsa përgjigjen nga AK e kemi pranuar me datë 13.02.2020
Të bashkangjitur janë F02 dhe vendimi i AK

7. **Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 28 – Specifikimet teknike
Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. **Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Duke u bazuar në të dhënat për të cilat na është lejuar qasja në dokumentet e OE të

përzgjedhur për kontratë, konstatojmë se AK ka bërë shkelje të LPP gjatë vlerësimit të tenderit duhe mos respektuar kriteret në Njoftimin për kontratë dhe Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD). Edhe pas kërkesës për Rishqyrtim të vendimit të AK të datës 10.02.2020, AK ka refuzuar të gjitha pretentimet tona përsëri duke shkelur dispozitat ligjore. Të dhënat faktike që mbështesin pretendimet tona janë:

- **Pretendimi nr.1. OE nuk ka dorëzuar deklaratë për specifikacionet teknike ashtu siç është kërkuar në FTD,** ***Neni 3.1 Specifikacionet teknike të detyrueshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit;.*** **Referuar RUOPP sqarohet qartë se "*Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm" – faqe nr.88.***
- **Pretendimi nr.2. Nuk është dorëzuar lista e kontratave duke plotësuar Aneksin 6 të dosjes së tenderit, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve. OE ka dorëzuar një listë të kontratave e cila nuk është në përputhje të plotë me Aneksin 6 (kërkesa nr.1). Në dosje të tenderit është kërkuar nga AK obligativisht "*Ky Aneks është obligativ qe te plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton performimin e tillë*" ndërsa lista e dorëzuar nuk përmban kolonat sipas Aneksit 6, pra mungojnë kolonat: Data e nënshkrimit te kontratës, Data e përfundimit te kontratës, E-maili i Blerësit dhe Numri i telefonit te Blerësit.** ***Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të verifikojë të dhënat e paraqitura në këtë Aneks dhe nëse vërtetohet ndonjë dëshmi e rreme, oferta e tillë do të konsiderohet si një oferte e pa përgjegjshme dhe për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme, do të kërkohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për të vënë atë në listën e zezë te Operatoreve Ekonomik*** **– dhe në mungesë të informacioneve që mungojnë nga tabela e dorëzuar nuk mund të bëhet verifikimi sipas kërkesës së AK. OE nuk ka përmbushur këtë kërkesë obligative të kërkuar nga AK në dosje të tenderit.**
- **Pretendimi nr.3. Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofertuara dhe katalogu (kërkesa nr.3). Është ofruar katalog vetëm për laurën automatike, TV outdoor dhe TV indoor ndërsa nuk ka ofruar katalogje për produktet tjera në listë sipas Aneksit 1 e që janë pjesa kryesore e sistemit funksionale:**
  - **Terminali hyrës dhe dalës**
  - **Senzori për matje të gjatësisë**
  - **Dritat e trafikut**
  - **Serveri qendror i sistemit**
  - **Terminali i pagesës**
  - **Softueri për informim të pasagjerëve**
  - **LED displej për perona**
  - **UPS**

  Nuk e kemi të qartë se si AK ka mundur të bëjë vlerësimin teknik sipas Aneksit 1 në mungesë të katalogjeve apo specifikacionit teknik. OE ka dorëzuar një listë të produkteve e cila nuk është në përputhje me kërkesat në Aneksin 1 si dhe këto informata të pakta nuk plotësojnë specifikat teknike sipas Aneksit 1. Andaj, mendojmë see ky OE është teknikisht i

papërgjegjshëm pasi që nuk mund të bëhet vlerësimi/krahasimi teknik i paisjeve të ofertuara konform Aneks 1.

- Pretendimi nr.4. Është kërkuar që OE duhet te kete Autorizim nga prodhuesi per Terminalet dhe monitorat, ndërsa OE ka dorëzuar autorizim për laura dhe TV indoor/outdoor. Pra, mungon autorizimi për terminal dhe monitora ashtu siq është kërkuar në dosje të tenderit (kërkesa nr.7). Autorizimi i dorëzuar nga Samsung Electronics Austria GmbH branch office Zagreb është lëshuar për distributorin e këtij prodhuesi i cili nuk është pjesëmarrës në këtë tender.
- Pretendimi nr.5. Është kërkuar që OE të jetë i certifikuar me ISO 9001, të dorëzohet origjinal ose kopje e noterizuar ndërsa OE i përzgjedhur për kontratë ka dorëzuar vetem kopje. Gjatë qasjes në dokumentacion nuk na është prezentuar asnjëra formë e kërkuar (origjinal apo kopje e noterizuar) siç është kërkuar në dosje të tenderit (kërkesa nr.8). Për koeçidencë data e certifikatës mban të njëjtën datë me datën e dorëzimit të tenderit (10.01.2020)
- Pretendimi nr.6. Në listën e produkteve të dorëzuar nga OE, pozicioni nr.20 TV outdoor model LH46OMDPWBC/EN pas verifikimit të specifikave sipas katalogut (gjuhën gjermane) dhe online shihet se ky model nuk i plotëson kërkesat teknike sipas Aneksit 1 pozicioni nr.7. - nuk plotëson:
    - Vandal proof grade structure (IK08)
    - Environment rating IP55
    - Operating temperature -30 / + 45°C
    - Shoch sensor
    - Backlight Life cycle 50.000 hours
    - Antiglare safety 4+3 tempered glass
- Pretendimi nr.7. OE i përzgjedhur për kontratë nuk ka ofertuar fare teminal hyrës dhe dalës por vetëm laurë automatike. Prodhuesi VDS i ofertuar nga OE i përzgjedhur nuk prodhon fare terminale sipas kerkese ne Aneksin 1 (https://www.vdsautomation.com/)
- Pretendimi nr.8. Nuk është ofertuar fare pozicioni nr.3. Sensor per matjen e gjatesis. Ky produkt nuk mund të gjindet në listën e paisjeve të ofertuara nga OE.

Duke marrë në konsideratë të gjitha argumentet të cilat u prezentuan më lartë si dhe vendimin mbi refuzimin e AK për të trajtuar këto argumente konform LPP-së, ne kërkojmë nga ju si Panel Shqyrtues i OSHP-së të merr në konsideratë të gjitha argumentet e lartë përmendura dhe të aprovoj kërkesën tonë si të bazuar duke kërkuar AK –së të anulojë vendimin mbi dhënie të kontratës dhe të kthej lëndën ne rivlerësim konform dispozitave ligjore të parapara me LPP.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Nëse nuk respektohen nenet e cekura më lartë na shkaktohet një dëmtim financiar në vlerë minimalisht 3,000.00 Euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) ***kopje të publikimit "Njoftimi për Kontratë"***
b) ***kopje të publikimit "Njoftimi për Dhënie të Kontratës"***
c) ***kopje të publikimit "B58 Njoftimi mbi vendimin e AK"***
d) ***kopje të publikimit "Letër standard për tenderuesin e pasuksesshëm"***
e) ***kopje të publikimit "Procesverbalit të hapjes së ofertave"***
f) ***kopje të Kërkesës për "Rishqyrtim të vendimit të AK – datë 10.02.2020"***
g) ***kopje të publikimit "Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se"***
h)
i) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*